

VENDIM
Nr. 295, datë 28.5.2025

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE, TË KRITEREVE, TË MOTIVIT DHE
TË PROCEDURAVE PËR DHËNIEN E MEDALJEVE E CERTIFIKATAVE NË
POLICINË E SHTETIT DHE SHPËRBLIMIN PËRKATËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 127, të ligjit nr. 82/2024, “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Për punonjësit e policisë, për merita në kryerjen e detyrave dhe për vjetërsi në shërbim, drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit jep këto medalje:

a) Medalje “Mirënjohje” i jepet:

i. punonjësit të policisë, i cili është dalluar për kontributin dhe vlerat e veçanta në shërbim të komunitetit;

ii. strukturës policore, që është dalluar për kontributin dhe vlerat e veçanta në shërbim të komunitetit.

Kjo medalje shoqërohet me shpërblim financiar në vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë, që përballohet nga buxheti i njësisë, ku është i punësuar punonjësi.

b) Medalje “Për rezultate të larta” i jepet punonjësit të policisë, që ka arritur tregues të lartë gjatë detyrës e që merr vlerësimet maksimale për një periudhë jo më pak se 5 (pesë) vjet.

Kjo medalje shoqërohet me shpërblim financiar në vlerën 90 000 (nëntëdhjetë mijë) lekë, që përballohet nga buxheti i njësisë, ku është i punësuar punonjësi.

c) Medalje “Për merita të veçanta” i jepet punonjësit të policisë për arritje të veçanta në kryerjen e detyrave të tyre dhe që shfaqin sjellje shembullore për një periudhë jo më pak se 5 (pesë) vjet.

Kjo medalje shoqërohet me shpërblim financiar në vlerën 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë, që përballohet nga buxheti i njësisë, ku është i punësuar punonjësi.

ç) Medalje bronzi e karrierës 15-vjeçare i jepet punonjësit të policisë, që ka shërbyer në strukturat e Policisë së Shtetit për 15 (pesëmbëdhjetë) vjet e gjatë kësaj periudhe ka dëshmuar profesionalizëm dhe sjellja e tij ka qenë shumë e mirë.

Kjo medalje shoqërohet me shpërblim financiar në vlerën 75 000 (shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë, që përballohet nga buxheti i njësisë, ku është i punësuar punonjësi.

d) Medalje argjendi e karrierës 20-vjeçare i jepet punonjësit të policisë, që ka shërbyer në strukturat e Policisë së Shtetit për 20 (njëzet) vjet e gjatë kësaj periudhe ka dëshmuar profesionalizëm dhe sjellja e tij ka qenë shumë e mirë.

Kjo medalje shoqërohet me shpërblim financiar në vlerën 85 000 (tetëdhjetë e pesë mijë) lekë, që përballohet nga buxheti i njësisë, ku është i punësuar punonjësi.

dh) Medalje ari e karrierës 30-vjeçare i jepet punonjësit të policisë, që ka shërbyer në strukturat e Policisë së Shtetit për 30 (tridhjetë) vjet e gjatë kësaj periudhe ka dëshmuar profesionalizëm dhe sjellja e tij ka qenë shumë e mirë.

Kjo medalje shoqërohet me shpërblim financiar në vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë, që përballohet nga buxheti i njësisë, ku është i punësuar punonjësi.

2. Punonjësi i propozuar për dhënie të medaljes nuk duhet të ketë masë disiplinore në fuqi apo të ketë marrë më parë masë disiplinore për shkelje të rëndë gjatë viteve të punës në strukturat e Policisë së Shtetit.

3. Medaljet shoqërohen me 1 (një) certifikatë.

Certifikata duhet të përmbajë lart, në qendër, stemën e Republikës së Shqipërisë, institucionin, autoritetin që jep medaljen, gradën, emrin dhe mbiemrin e personit që i jepet medalja, titullin e

medaljes, motivacionin, numrin dhe datën e urdhrit për dhënien e medaljes, si dhe në fund, emrin, mbiemrin e firmën e drejtorit të përgjithshëm që jep medaljen dhe vulën.

4. Për punonjësit e policisë jepen këto lloj certifikatash:

a) Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit jep:

i. certifikatë për shërbime të dalluara për punonjësin e policisë, që ka kryer shërbim të dalluar në mënyrë të vazhdueshme dhe për një periudhë kohe jo më pak se 3 (tre) vjet, duke shfaqur profesionalizëm e rezultate të larta në punë.

Certifikata për shërbime të dalluara, e cila shoqërohet me shpërblim financiar në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, që përballohet nga buxheti i njësisë, ku është i punësuar punonjësi.

ii. certifikatë të karrierës, që i jepet punonjësit të policisë, që ka mbushur më shumë se 10 (dhjetë) vjet punë/shërbim në Policinë e Shtetit, duke kontribuar në rritjen e standardeve të rendit dhe të sigurisë publike.

Certifikata e karrierës shoqërohet me shpërblim financiar në vlerën 45 000 (dyzet e pesë mijë) lekë, që përballohet nga buxheti i njësisë, ku punonjësi është i punësuar.

b) Drejtuesit e departamenteve të Policisë së Shtetit japin certifikata të karrierës për punonjësit e policisë në varësi të tyre. Certifikata e karrierës i jepet punonjësit të policisë, që ka mbushur më shumë se 10 (dhjetë) vjet punë/shërbim në Policinë e Shtetit, duke kontribuar në rritjen e standardeve të rendit e të sigurisë publike.

Certifikata e karrierës shoqërohet me shpërblim financiar në vlerën 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë, që përballohet nga buxheti i njësisë, ku është i punësuar punonjësi.

c) Drejtorët e drejtorive vendore të Policisë së Shtetit dhe drejtuesit e strukturave të veçanta japin certifikata për shërbime të dalluara për punonjësit e policisë në varësi të tyre. Certifikata për shërbime të dalluara i jepet punonjësit të policisë, që ka kryer shërbim të dalluar në mënyrë të vazhdueshme dhe për një periudhë kohe jo më pak se 3 (tre) vjet, duke shfaqur profesionalizëm e rezultate të larta në punë.

Certifikata për shërbime të dalluara shoqërohet me shpërblim financiar në vlerën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë, që përballohet nga buxheti i njësisë, ku është i punësuar punonjësi.

5. Punonjësi i propozuar për dhënie të certifikatës nuk duhet të ketë masë disiplinore në fuqi apo të ketë marrë më parë masë disiplinore për shkelje të rëndë gjatë viteve të punës në strukturat e Policisë së Shtetit.

6. Certifikata duhet të përmbajë: stemën e Republikës së Shqipërisë, llojin e certifikatës; gradën, emrin dhe mbiemrin e personit që certifikohet, numrin dhe datën e urdhrit, si dhe motivacionin për dhënien e saj, gradën, emrin dhe mbiemrin e autoritetit që jep certifikatën, firmën dhe vulën e institucionit.

7. Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit i jep medaljet dhe certifikatat kryesisht ose me propozim të drejtorëve të departamenteve dhe të drejtorëve të drejtorive në varësi të tij.

7.1. Drejtuesit e departamenteve i japin certifikatat me propozimin e drejtuesve të strukturave të varësisë.

7.2. Drejtuesit e drejtorive vendore dhe drejtuesit e strukturave të veçanta i japin certifikatat me propozimin e titullarëve të strukturave të varësisë.

8. Propozimi për dhënien e medaljeve dhe të certifikatave i bëhet autoritetit përgjegjës për dhënien e tyre. Propozimi për dhënien e medaljeve dhe të certifikatave duhet të përmbajë:

a) gjenealogjetet, vendin e punës dhe funksionin e punonjësit;

b) ecurinë në karrierë;

c) relacionin për arritjet dhe sukseset në punë, që do të përcaktojnë dhe motivacionin për dhënien e tyre, arsyet e hollësishme të propozimit, motivin dhe elementet që vërtetojnë përmbushjen e kriterëve përkatëse për dhënien e medaljes/certifikatës;

ç) autoritetin propozues;

d) llojin e medaljes/certifikatës që propozohet të jepet;

dh) vërtetimin nga struktura e burimeve njerëzore pranë strukturës propozuese se personi i propozuar nuk ka marrë më parë këtë lloj medaljeje (përveç medaljes së karrierës);

e) vërtetimin nga struktura e burimeve njerëzore pranë strukturës propozuese se personi i propozuar nuk ka masë disiplinore në fuqi dhe nuk ka marrë më parë masë disiplinore për shkelje të rëndë gjatë viteve të punës në strukturat e Policisë së Shtetit.

9. Propozimi për dhënien e medaljes bëhet me shkrim dhe i dërgohet autoritetit përgjegjës për dhënien e tyre 90 (nëntëdhjetë) ditë përpara datës së propozuar për dhënien e medaljes.

10. Propozimi për dhënien e certifikatës bëhet me shkrim dhe i dërgohet autoritetit përgjegjës për dhënien e tyre 30 (tridhjetë) ditë përpara datës së propozuar për dhënien e certifikatës.

11. Strukturat e burimeve njerëzore në varësi të autoritetit përgjegjës, që jep medaljen/certifikatën, kryejnë shqyrtimin e propozimit për dhënie medaljeje/certifikate dhe marrin miratimin në parim nga autoriteti përgjegjës për dhënien e medaljes. Pas këtyre procedurave, këto struktura përgatitin urdhrin përkatës për autoritetin që jep medaljen/certifikatën brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve.

12. Procedura e dorëzimit të medaljeve dhe të certifikatave është, si më poshtë vijon:

a) Dhënia e medaljeve dhe e certifikatave bëhet me ceremoni zyrtare nga autoritetet përkatëse;

b) Struktura e protokollit dhe e ceremonive, pas miratimit të medaljes apo të certifikatës nga titullari i përcaktuar, bën njoftimin për institucionin apo strukturën, që ka bërë propozimin dhe, në bashkëpunim, përcaktojnë kohën e vendin e dhënies së saj për medaljet/certifikatat e akorduara nga drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit;

c) Dhënia e medaljeve dhe e certifikatave mund të realizohet gjatë ceremonive të ndryshme për festim përvjetorësh ose në raste festash zyrtare. Ceremonia në këto raste organizohet në vendin e punës apo në institucionin që e ka bërë propozimin për dhënien e saj;

ç) Dorëzimi i medaljeve dhe i certifikatave bëhet në mënyrë publike, në prani të punonjësve të Policisë së strukturës ku shërben punonjësi ose të strukturës që ka bërë propozimin.

13. Kopje të urdhrave për akordim të medaljeve dhe të certifikatave, së bashku me kopjen e certifikatave, vendosen në dosjen personale të punonjësit të Policisë, si dhe pasqyrohen në vlerësimin e rezultateve të punës që bëhet për punonjës.

14. Medaljet mbahen në uniformën e punonjësit të policisë dhe në uniformën ceremoniale. Punonjësit e policisë, përveç medaljeve të dhëna sipas ligjit për Policinë e Shtetit, gëzojnë të drejtën të mbajnë edhe medalje, dekorata e tituj nderi të dhëna nga institucione dhe autoritete të tjera publike, si dhe nga institucione e autoritete të shteteve të tjera.

15. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2026.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku